Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/497
Datë: 27.11.2020

Në mbështetje të neneve 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 28.10.2020 nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **Akreditohet** "Agjencioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë" (APPK), me adresë Rr. "Rexhep Krasniqi", Nr. 59, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 28.10.2020 deri 28.10.2023, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla,** Niveli III sipas KKK, me 7 kredi të AAP. APPK për këtë profil mund t'i ketë 10 grupe në vit. Numri i kandidatëve brenda një grupi mund të jetë jo më shumë se 20 kandidatë.
2. **Gjuhë Gjermane.** APPK për këtë profil mund t'i ketë 42 grupe në vit. Numri i kandidatëve brenda një grupi mund të jetë jo më shumë se 15 kandidatë.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Agjencionit të Përkrahjes së Punësimit Kosovë"për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Rivalidimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Riakreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues dhe

lëshues të kualifikimit; Raporti i Vetëvlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tëtjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturat nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. "Agjencioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë" - APPK;
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD së AKK